
DOKUMENTE E MATERIALE

PESHKOPËT E PULTIT TË MADH E TË VOGËL

Përktheu nga latinishtja: Arjan KOÇI

Marrë nga *Illyrici Sacri*, Tomus VII

Në kreshtë të një mali ndodhej Pulti (Pulatum ose Polletum), qytet shumë i vjetër, ndoshta aty ku gjendej qyteti Ptolemaika (Aequum) ose sigurisht jo larg tij. Ishte larg prej Shkodrës, nga Veriu, rreth 30 mijë hapa. Nga luftërat e shpeshta dhe sulmet e barbarëve, të cilët e shkretuan atë krahinë, ky qytet u rrënuar prej themelesh dhe shenjat e tij duken fare pak ose aspak. Që në shek. IX ishte qytet peshkopal, siç konstatohet nga Koncili Delmitan, me vendim të të cilit dioqeza e Pultit që përfshirë në krahinën dhe Mitropolinë e Dioklesë dhe mbante juridiksionin dhe titullin peshkopal. Kjo dioqezë është e hapur prej Perëndimi në Lindje pesë ditë udhë dhe prej Veriut në Jug tri ditë udhë. Lumi Valbonë e ndan nga Serbia; Drini e ndan nga dioqeza e Sapës, malet Biskav e Kalogjer nga dioqeza e sotshme e Shkodrës. Pultin e ndan në dy pjesë ky mal më i lartë se të tjerët, i quajtur Ndermajë. Pjesa këndeje merr nga jugu dhe ka pesë katunde ose famulli kryesore, që në gjuhën e vendasve quhen Shalë, Shoshë, Kir, Plan dhe Gjan. Në katër famullitë e para shërbejnë si famullitarë etërit françeskanë të rregullit të rreptë, të cilët Kongregacioni i Shenjtë i Propagandës së Fesë i vendosi atje si famullitarë të fesë dhe administratorë të çështjes së krishterë. Famullitar të famullisë së Gjanit dhe të Kishës së Shën Nikollit peshkopi zakonisht emëron një meshtar të klerit shekullar dhe aty peshkopi vendos edhe selinë e vet peshkopale. Kisha e Shën Nikollit, e cila në vitin 1713 që ndërtuar pak më e gjerë dhe më e bukur, ka marrë nderin dhe titullin e katedrales. Peshkopët e mëparshëm qëndruan herë në Plan e herë në katunde e famulli të tjera. Në tokën e Shalës shihen shenjat e një qyteti fort të lashtë, që thuhet se ishte quajtur Mauricum. Fusha përreth është e ujitur dhe pjellore. Gjenden edhe themelet dhe rrënojat e shtatë kishave, ndër të cilat duket se kanë qenë mjaft të mëdha e të punuara bukur. Për më tepër, thuhet se njëra nga këto të dyja, e veçuar në shenjë me titullin dhe nderin e abatit, e që ishte ngjitur me kuvendin, pati qenë e murgjërve benediktinë. Në katundin e Kirit shihen rrënojat e katër kishave të vogla dhe në Gjanë rrënojat e tri kishave. Këta popuj këndeje malit në gjuhën e vet quhen Pultijë, domethënë ndoshta të Pultit të Vogël. Pas malit Ndermajë vendasit gjenden me shumicë në katër katundet: Blaki, Salcë, Toplanë, Dushman. Përreth shihen gjithnjë gërmadhat e shumë kishave, që mbërrijnë në 18. Këtyre shtojnë edhe tre katunde të tjera, që nga popujt e afërm të Gjakovës, Pejës, Prizrenit u përliden me

skizmë. Të gjithë popujt e tjerë të lartpërmendur, këndej e andej Ndërmajes e mbajnë shenjtërisht fenë e krishterë dhe e mbrojnë trimërisht. Të gjitha punët e fesë i kryejnë haptazi dhe lirisht qoftë në kishë qoftë në lutje solemne. Ka popuj si ai i Kelmendit dhe të tjerë të asaj krahine malore që nuk janë në zgjedhën e robërisë turke dhe që nuk i paguajnë asnjë haraç Turqisë. Qëndresa e këtyre popujve në ruajtjen dhe ushtrimin e fesë duhet t'u njihet fretërve të vegjël të Urdhrit të Shën Françeskut, të cilët gati kudo kryejnë detyrën e famullitarit dhe i mësojnë pa ndërprerje ata popuj me predikime e katekizëm. I edukojnë me urdhërimet e Zotit dhe u shpjegojnë sakramentet me mund të madh e pa u lodhur kurrë, u shërbejnë dhe i drejtojnë në udhët e Zotit. Këtë përshkrim të kësaj dioqeze të Pultit e nxorëm nga një shkresë e bërë nga peshkopi i tanishëm, i quajtur Aleksandër Blanko. Sinodi krahinor ose kombëtar i Shqipërisë mbajtur në vitin 1703 nën kryesinë e Vincenc Smajevicit, kryepeshkopit të Tivarit e të Dioklesë, e primat i Mbretërisë Serbe, dioqezën e Pultit në pjesën 3 kr. 5 e përcakton me këta kufij:

Për të ndihmuar me mjete paraprake në rregullimin e mospajtimit që kanë mes tyre peshkopi i Pultit me Kryepeshkopatën e Tivarit dhe Administratorin e Serbisë në dëm të besimtarëve të të dyja palëve, mbështetur në dokumente të vjetra dhe në dëshminë e njëzëshme të popujve, dëshmojmë se dioqeza e Pultit ka këta kufij:

Nga jugu ka si kufi lumin Drin e krahinën e Postribës. Nga perëndimi e veriu ka si kufi malet Biskav e Kalogjer. Nga lindja ndahet me Mbretërinë Serbe me lumin Kasterigj ose Kastranik ose Valbonë, lumë që ka tre emra. Në anë tjetër, nga krahina e Postribës, që tregon në kr. 6 se gjendet në kufijtë jugorë të kësaj dioqeze, ia njeh juridiksionit të peshkopit të Pultit tre katunde: "Pastaj tre katundet Arrë, Kurthë e Vilë i kanë nën sundim etërit misionarë të Toplanës së dioqezës së Pultit dhe ata u bëjnë shërbimin famullitar".

Ndër tabulat dhe dokumentet kishtarë shihet se paskan qenë dy Pulta: Pulti i Madh e Pulti i vogël dhe secili ka pasur peshkopin e vet. Por është e vështirë të përcaktohet vendi i secilit dhe të dallohet njëri prej tjetrit me kufij të sigurt sepse kujtimi i dy Pultave është zhdukur.

Françeskani Atë Luigji, Prefekt i Misionit të Pultit, në letrën që i dërgon Lazer Vladanjit, Kryepeshkopit të Tivarit, për dallimin e dy Pultave tregon se ka bërë një hetim duke vëzhguar me kujdes vendet dhe duke pyetur vendasit; gjë që i duket se ka gjasa. Katundet e lartpërmendura, që i përmend në letrën e vet Aleksandri, peshkopi i Pultit, duhet t'i atribuohen Pultit të Vogël; Pulti, Kiri, Gjani, Fogu e Mëngula, kurse Shala, Shoshi, Nikaj e Toplana dhe Blakije t'i atribuohen Pultit të Madh.

Më duket shumë me vend përshkrimi i ndarjes së mbarë krahinës së Pultit, të cilën Aleksandër Blanku, që tashti e përmendëm, e sjell të ndarë nga mali Ndërmaje dhe jam i mendimit se famullitë që përmend përtej atij mali i përkasin Pultit të Madh, kurse ato këndej atij mali i përkasin Pultit të Vogël.

Mund të thuhet se Pulti i Madh gjendet andej malit kurse Pulti i Vogël këndej. Nga vëzhgimet e mia gjej se Pulti ndahej në Pultin e Epërm dhe në Pultin e Poshtëm. Pulti i Epërm është Pulti i Madh, kurse Pulti i Poshtëm është Pulti i Vogël këndej malit. Po të mbajmë këtë dallim, famullitë e Shalës e të Shoshit, të cilat at Luigji ia njeh Pultit të Madh, në të vërtetë duhet t'i përkasin Pultit të Vogël. Dhe nuk është larg së vërtetës që mali shumë i lartë i Ndërmajes gjendet në mes të Pultit të Madh e të Vogël dhe se nga ai mal ndahet njëri Pult nga tjetri sepse kufijtë e krahinave do të kërkohen prej malesh a lumenjsh që janë ndërmjet.

Qyteti i Pultit, prej nga e merr emrin tërë ajo krahinë, duhet të ketë qenë më tepër në Pultin e Madh se në të Voglin.

Papa Piu II në letrën e vet drejtuar mitropolive të Durrësit e të Tivarit (letër që u përshkrua të Pjetri II, Kryepeshkopi i Tivarit) duket se bën fjalë për Pultin e Madh, kur vëllezërit e Lekë Dukagjinit i quajtën të Pultit të Madh, d.m.th. aty ku kishin principatën e vet. Sikurse janë dy gjëra të ndara qyteti dhe kisha peshkopale, ashtu edhe selitë peshkopale qenë dy, edhe peshkopët; ai i Pultit të Madh dhe tjetri i Pultit të Vogël.

Në shek. XVI qe hequr çdo dallim mes Pultit të Madh dhe Pultit të Vogël dhe qe bërë një dioqezë e vetme, me një peshkop të vetëm.

Në fillim ka qenë një peshkop i vetëm për të gjithë Pultin dhe para shekullit XIV nuk shihet ndër katalogët e krishterë ndonjë dallim mes Pultit të Madh e të Vogël.

Peshkopi i Pultit të Vogël quhej zakonisht edhe i Skordit, siç shihet në Kodin e Pagesave të Dhomës Apostolike 193, fq. 188, ku është shkruar:

"Më 26 dhjetor 1352, Tagrambledhësi Apostolik i të dhjetave trevjeçare i caktuar prej Papës mori dhjetë solda të trasha nga Gregori peshkopi i Pultit të Vogël ose Skordit." Prapë në libr. 403 të hyrje-daljeve të Dhomës, fq. 200, tregohet se Kryepeshkopi i Tivarit në vitin 1634 i pagoi Egjdit, peshkop i Sabinis dhe Legat Apostolik, ato që kishte detyrë për vete e për sufraganët e vet, ndër të cilët këta tre peshkopë: i Pultit, i Skodonit e i treti i Shkodrës.

Peshkopi i Skodonit, i dalluar nga ai i Pultit dhe i Shkodrës, nuk mund të jetë tjetër vetëm se ai i Pultit të Vogël, që quhej Scordiensis, Scordinensis dhe Scodonensis. Dioqeza këndej Alpeve e peshkopit të Pultit të Vogël kufizohet nga perëndimi dhe jugu me dioqezën e Shkodrës, së cilës dikur ndoshta i ka përkatur.

Unë mendoj se për këtë arsye do ketë qenë quajtur Scordiensis e Scodrinensis. Që dioqeza e Shkodrës (Scodrensis) të mos mund të ngatërrohej me atë që quhej i Skordit (Scordiensis), që atëherë nuk qe thirrur më Scodrensis, por Scutarensis, siç vë në dukje kardinal Garampi. Dhe që në shek.XIII e deri në kohët tona ndër dokumentet e krishtera Shkodra qe quajtur Scutarensis. Kur pas kësaj ndarjeje, do të hasësh peshkopët e Pultit, por pa u

dalluar a janë të Pultit të Madh e Pultit të Vogël apo Skord (Scordiensis), mendoj se i duhen atribuuar Pultit të Madh.

Pos emrave të peshkopëve e sidomos të vjetër të të dy dioqezave të Pultit, të pakta janë lajmet që kemi për të dhënë. Shpesh edhe emrat e tyre i ka rrëmbyer vjetërsia e harresa.

Kjo është lista e peshkopëve të Pultit, të cilët pas shek. XIII filluan të thirreshin të Pultit të Madh, por me shumë ndërprerje.

1. N. N.	viti	877	8. N.N	viti	1308
2. NN	viti	1062	9. N.N	viti	1351
3. N.N	viti	1121	10. N. N.	viti	1372
4. Theodori	viti	1141	11. Menelau	viti	1421
5. Gjoni	viti	1199	12. Nikolla	viti	1450
6. N. N.	viti	1227	13. Stefani	viti	s'dihet
7. Andrea	viti	1251	14. Gjoni II	viti	1475
15. Isidori	viti	1518	22. Marku	viti	1731
16. Laurenti	viti	1529	23. Serafini	viti	1745
17. Martini	viti	1574	24. Gjergji	viti	1756
18. Vinçenci	viti	1656	25. Aleksandri	viti	1766
19. Pjetri	viti	1698	26. Gjoni III	viti	1781
20. Martini	viti	1703	27. Marku II	viti	1791
21. Pjetri II	viti	1714	28. Engjëlli	viti	1816

N. N. peshkop i Pultit I, viti 887

Para shek. IX nuk përmenden dioqeza dhe peshkopët e Pultit. Rreth vitit 877, në Koncilin Delmitan, që e kemi përmendur fort shpesh, ndër dioqezat që i përkisnin Mitropolitit të Dioklesë përmendet Pulti. Pastaj deri pas gjysmës së shek. XI nuk kemi mundur ta hasim askund emrin e kësaj peshkopate.

N. N. peshkop i Pultit II, viti 1062

Pas gati 140 vitesh, u duk se po ringjallej dioqeza e Pultit nga letra e papës Aleksandri II dërguar nga Roma në vitin 1062 Pjetrit, Kryepeshkopit të Tivarit, të cilit Papa ia nënshtron dioqezën e peshkopatën e Pultit. Por nga fundi i këtij shekulli, kur nuk u krijua më Mitropolia e Tivarit, dioqezën e Pultit bashkë me dioqeza të tjera të krahinës së Tivarit ia nënshtrori pushtetit të Kryepeshkopit të Raguzës.

N. N. peshkop i Pultit III, viti 1121

Papa Kalisto II në letrën e vet dërguar Geraldit, peshkopit të qytetit të Raguzës, shkruan: "Edhe qyteti i Kotorrit... e Pulti me abacitë etj., në të ardhmen të mbështeten ty dhe pasardhësve të tu e do të ruhen në tërësi."

Theodhori, peshkop i Pultit IV, viti 1141

Këtë peshkop Maurus Orbini në Komentaret e vet Mbi Mbretërinë Serbe, fq. 747, e njeh në vitin 1141 ndër peshkopët e krahinës së Raguzës. Adriani IV në vitin 1158, Aleksandri III në vitin 1167, në letrat e veta dërguar Tribunit, Kryepeshkopit të Raguzës, bashkë me të tjera dioqeza të Dalmacisë së Epërme shprehimisht ia nënshtrojnë Pultin Mitropolitit të Raguzës.

Vetë Papa Aleksandri po në atë vit u dha urdhër peshkopëve të Pultit dhe Shasit që nuk i bindeshin sundimit të Kryepeshkopit të Raguzës, t'i nënshtroheshin këtij dhe ta dëgjonin, po s'deshën të ndëshkoheshin me ndëshkimet e drejta e të merituarra kanonike nga Legati Apostolik që do të dërgonte në Dalmaci së shpejti. Këndej shohim se në atë vit dioqezës së Pultit nuk i munguan peshkopët, megjithëse nuk dimë as emrat e as kohën e shërbimit të tyre.

Si u ripërtëri Mitropolia e Tivarit, Pulti u kthye nën pushtetin e këtij, me gjithë kundërshtimet e Kryepeshkopit të Raguzës, i cili nxori prej Papës njohjen e pushtetit mbi Pult dhe dioqezat e tjera të Dalmacisë së Epërme.

Gjoni, peshkop i Pultit V, viti 1199

Nënshkrimi i tij lexohet në Koncilin e Dioklesë në vitin 1199, nën Mitropolitin e Dioklesë e të Tivarit, "Gjoni Peshkopi i Pultit".

N.N. peshkop i Pultit VI, viti 1227

Duke qenë anonim, Papa Gregori X, në vitin 1227 e deklaroi me të tjerë peshkopë të krahinës së Tivarit nën Arrengjerin, Mitropolitin e Raguzës.

N.N. peshkop i Pultit VII, viti 1251

Emrin e këtij e kemi nga kopjet e formulës juridike, me të cilën Salvi, peshkopi i Tribunit, me urdhër të Inocentit IV, detyronte në vitin 1251 të paraqiteshin pranë Kurjes Papnore peshkopin e Drishtit e të Pultit, që të jepnin arsye përse nuk donin t'i nënshtroheshin Kryepeshkopit të Raguzës. Në formulën e parë kundër peshkopit të Drishtit përmendet si i pranishëm e dëshmitar "Dom Gjoni i nipi i Andreas, peshkopit të Pultit". E dyta i kishte shkuar e dërguar "Andreas, peshkopit të Pultit", të cilin peshkopi i Drishtit në emër të vet dhe bashkë me letrën e Salvit, peshkopit të Tribunit, u kujdes ta paraqesë në një mbledhje të disa peshkopëve në Tivar.

Në vitin 1251 të Krishtit, të Zotit tonë Jezu Krisht, më 27 prill, indicie VIII, në prani të atyre, emrat e të cilëve do të rreshtohen më poshtë:

Meshtari Desinja, Nunc i Z. Salvit, peshkop i Tribunit, ia paraqiti letrën e tij peshkopit të Drishtit. Kjo letër i dërgohej Andreas, peshkopit të Pultit, me anë të meshtarit Desinja. Këtë letër e mori në dorëzim në vend të peshkopit të Pultit ai i Drishtit. Pas pak kohe e paraqiti me këtë përmbajtje: "Të Ndershmit Atë në Krishtin, për hir të Zotit, peshkop i Pultit, Salvi, nga i njëjti hir, peshkop i Tribunit, shëndet në Zotin.

Ta këtë të ditur Zotëria Juaj se kemi marrë nga Papa i Shenjtë këtë letër: Inocenti peshkop etj." Kjo letër qe përshkruar te Gjoni III Kryepeshkop i Raguzës.

"Duke qenë se urdhrin e Papës s'mundemi as s'duhet ta lëmë pas dore, me autoritet të dhënë për t'ju urdhëruar, po ju japim urdhër që brenda tetë muajsh, sipas urdhrin papnor, afat që e pamë më të udhës ta vëmë, të paraqiteni te Papa ju personalisht e me anë të një zëvendësi të përshtatshëm për ju bashkë me akte, privilegje e dokumente, me tagre e arsye, për t'i dhënë përgjigje të lartpërmendurit Kryepeshkop, domethënë të Raguzës, ose zëvendësit të ligjshëm të tij.

U redaktua në banesën e peshkopit të Drishtit, duke qenë pranë kryemeshtari Mëhill, meshtari Gjoni, i nipi i peshkopit të Pultit, dhjaku Gjon, i vëllai i Kontit të Drishtit, dhjaku ... Edhe unë Bonakursi Noter, mora pjesë në të gjitha këto dhe i shkrova, i plotësova dhe i forcova.

Në atë ditë, muaj e indicie si më sipër dhe në atë mbledhje të peshkopëve në Tivar, në prani të peshkopit të Shasit e të Ulqinit, Andrea peshkopi i Pultit, dëshmoi se e kishte marrë letrën nga peshkopi i Drishtit, që e pati marrë në dorëzim në vend të tij."

Pas Andreas dioqeza e Pultit i qe nënshtuar Mitropolitit të Tivarit dhe nuk kaloi më nën ndonjë tjetër.

Sa u tha deri tani rreth kapjes pas Kryepeshkopëve të Raguzës e të Tivarit për tagrin mitropolit mbi dioqezat e Dalmacisë së Epërme e të Pultit dhe letrat papnore rreth kësaj çështjeje, do t'i gjesh në vende përkatëse nëpër historinë e dioqezave të Raguzës e Tivarit. Mbi peshkopët e Pultit pas Andreas, nëse ka pasur, deri në vitin 1308 nuk kemi dijeni.

N.N. peshkop i Pultit VIII, viti 1308

E njohim nga letra e Papës Klement V, që në vitin 1308 urdhëron Mitropolinë e Tivarit që bashkë me peshkopët e krahinës së tij të merrte pjesë në Koncilin e Vienës në Francë. Peshkopin e Pultit e cilëson me fjalët: "Urdhërojmë që ju o vëllezër, kryepeshkop dhe peshkopë të Pultit e të Shasit", siç u tha te Andrea, Kryepeshkopi XI i Tivarit. As nga peshkopët e Pultit të Vogël nuk e dimë se kush mund të jetë ky peshkop, pasi peshkopët e Pultit të Vogël fillojnë nga gjysma e shekullit XIV.

N.N. peshkop i Pultit IX, viti 1351

Në vitin 1351 sundonte këtë dioqezë. Në këtë vit i shleu Arkës Apostolike atë që i detyrohej, siç jepet në Kodin e Pagesave të Dhomës Apostolike: "Tagrambledhësi Apostolik i të dhjetës trevjeçare të vendosur nga Papa në vitin 1351" tregohet se pat marrë "më 26 dhjetor 40 solda të trasha nga peshkopi i Pultit ashtu edhe nga Gregori peshkopi i Pultit të Vogël quajtur edhe Skord, 10 solda të trasha".

Që këtu kemi në një vit dy peshkopë të Pultit. Njëri është anonim dhe quhet thjeshtë i Pultit, tjetri me emrin Gregor i Pultit të Vogël apo Skordit. Që këndeji fillon të shihet dallimi mes dioqezës dhe peshkopit të Pultit të Madh e të Vogël.

N.N. peshkop i Pultit X, viti 1372

Këtë na e tregon Kodi 240 i Pagesave të Dhomës Apostolike, fq. 269, ku thuhet se "peshkopit të Pultit" me të tjerë të krahinës së Tivarit i qe falur në vitin 1372 për arsye skamjeje e dhjeta që i detyrohej Selisë Apostolike. Po kështu edhe atij të Skordit, d.m.th. të Pultit të Vogël dhe të Shkodrës, Scutarensis, që duhet dalluar nga Scordiniensis.

Helena, e veja e Stefan Dushanit, e cila mbretëronte në Serbi apo Rashë bashkë me të birin të quajtur Urosh i shtypte egërsisht katolikët, duke i rrëmbyer këtyre peshkopëve çdo pasuri. Prandaj në këtë shekull të XIV nuk gjej asnjë peshkop të Pultit të Madh.

Menelau, peshkop i Pultit XI, viti 1421

Në vitin 1421, Papa Martini V ia dha Menelaut në sundim dioqezën e Pultit, siç na tregojnë Aktet Konçistoriale: "Në vitin 1421, më 3 maj, qe emëruar Menela Xakaria peshkop i "dioqezës së Pultit në krahinën e Tivarit, në Shqipëri, mbetur vakant me vdekjen e peshkopit të mëparshëm."

Nga përmbajtja e kësaj formule mund të mendojmë se pas anonimit do të ketë pasur të tjerë peshkopë Pulti sepse pas vdekjes së peshkopit të fundit, pas shumë kohësh qe vënë në vend të tij Menelau. Por unë nuk kam dijeni për të.

Nikolla, peshkop i Pultit XII, viti 1454

E njohim nga letra e Papës Kalistit III, dërguar më 1 qershor 1457, peshkopit të Sapës dhe Gulielmit de Lauro, me titullin Baçelor në Teologjinë e Shenjtë, duke dhënë urdhrin të bënin hetime juridike për krimet që i ishin atribuar Pal Engjëllit, Kryepeshkopit të Krajës. Më të rëndat ishin ato sipas së cilave ai paska predikuar pa pikë turpi në publik saqë të Ndertit vëllait tonë, Nikollë peshkopit të Pultit, e të shumë njerëzve të tjerë fisnikë e me rëndësi, se feja greke është më e vërtetë se ajo që mëson Kisha e Shenjtë Romane, se riti grek është më i rëndësishëm se ai i kishës së Romës etj.

Pali qe emëruar Kryepeshkop i Krajës në vitin 1455. Nikolla me siguri në vitin 1457 është peshkop i Pultit dhe fare lehtë mund të përkojë me të, me sa na tregon Biemi në jetën e Skënderbeut, se ndodhen në Pult në vitin 1454. Pasi

vdiq Pjetri Shpani dinast i Pultit, djemtë e tij u përçanë dhe secili mbështetej në palën e vet, kurse dy qytetet, Shala dhe Shasi, u shkëputën botërisht prej tyre. Skënderbeu, që gjendej duke dimëruar që nga dhjetori 1454, pas disa luftërash kundër turqve, përpjekjesh e lëvizjesh luftarake, i lutur prej Pal Engjëllit peshkop i Drishtit, erdhi në Pult dhe në pak kohë ia doli që me autoritetin dhe fuqinë e vet t'i rregullojë e t'i afrojë si duhet vëllezërit që ishin në mosmarrëveshje njëri me tjetrin, me përjashtim të të voglit, Markut, të cilin pasi e kundërshtoi me egërsi, e lidhi si shkaktar kryesor të përçarjes.

Stefani, peshkop i Pultit XIII, viti s'dihet

Stefani Peshkop i Pultit - Përveç emrit, nuk i dihet gjë tjetër.

Gjoni, peshkop i Pultit XIV, 1472

Këtë peshkop si dhe të mëparshmin, Stefanin, na e tregon Kardinal Garampi, me këto fjalë, siç i ka marrë prej tabulave romane: "Më 10 maj 1475, Gjoni bëhet peshkop i dioqezës së Pultit të Madh pas vdekjes së Stefanit". Peshkopët e tjerë të dioqezës së Pultit në këtë shekull qenë përpirë nga harresa e vjetërsia.

Isidori, peshkop i Pultit XV, viti 1518

Mbi këtë na flasin Aktet Konciliare: Papa Leoni X më "12 prill 1518 emëroi për dioqezë të Pultit të Madh Kryepeshkopin e Brindizit. "Pulti i Madh, megjithëse gjendet në krahinë të të pafeve, ka në qytet e dioqezë disa të krishterë, prandaj i emëruari duhet të shkojë atje sa më shpejt të jetë e mundur për të banuar atje e për të kryer shërbimin."

Tabulat Konçistoriale tregojnë se Isidori qe transferuar nga Pulti në Mitropolinë e Hjerecit në "vitin 1524 më 23 shtator". Papa Klementi VIII e transferoi peshkopin e Pultit në Mitropolinë e Hjerecit në Qipro, të cilit i qe bashkuar Manastiri i Shën Stefanit de Pina të dioqezës së Splitit, mbetur vakant nga vdekja e kardinalit Kavalivcen."

Laurenti, peshkop i Drishtit XVI, viti 1529

Mbiemri i tij ishte Santarelus. Papa Klementi VII e bëri administrator të kësaj dioqeze të Pultit më 7 qershor 1529, sipas letrës së Kardinal Garampit.

Martini, peshkop i Pultit XVII, viti 1529

Qe polak me kombësi, i Urdhrit të Predikatarëve. Në vitin 1574 sundon dioqezën e Pultit. Për këtë na flasin Frydrycoviczius fq. 233, Kavaleri bleu I, fq. 439 & Fontana fq. 267, tit. 473. Ky e ngatërron Martinin, peshkopin e Pultit, me Vinçenc Skalonen, peshkopin e Pultit të Vogël, si të ishte një e vetme ajo peshkopatë e asaj dioqeze. Fontana thotë: "P.F. Martini, polak, qe caktuar për Selinë Peshkopale të Pultit prej Papës Gregorit VIII në vitin 1574. Nga Aktet

Koncistoriale të atij pape". Fytyra e tij shfaqet e pikturuar në anë të majtë të kapitullit të kuvendit domenikan në Tuluzë, me këtë shkrim poshtë: "NF . Martini polak, në shenjë për tagër kanonik e të vjetër. Penitencjar i parë në Kurjen Romane, peshkop i Pultit, lulëzoi në Poloni rreth vitit 1574." Duke mos pasur mundësi të shkojë në dioqezën e caktuar, e kaloi jetën në vendlindje dhe punët peshkopale i kreu kur pati rast, si ndihmës.

Këto janë nga dokumentet e Kuvendit të Tuluzës botuar prej Atë Percin fq. 146.

Pas Martinit, Pulti mbeti pa peshkop për tetëdhjetë vjet pasi nuk kam hasur asnjë peshkop të tij. E kështu gjatë këtyre viteve dioqeza e Pultit qe administruar nga peshkopët kufitarë apo nga vikarë apostolikë. Aleksandër Bardhi, peshkop i Pultit, tregon se ka dëgjuar që vendasit paskan vrarë një peshkop, s'di se cilin, e prandaj u bënë kështu të padenjë që t'u jepej peshkop.

Në vitin 1618 i shërbente dioqezës së Pultit Pjetër Mazreku, vikar apostolik, dhe në këto vite në një letër që i dërgon Selisë Apostolike, më 8 qershor, nxori shumë gjëra të nevojshme për ndihmën e ngushëllimin e atyre popujve. Benedikt Orsini, peshkop i Lezhës dhe administrator i dioqezës së Shkodrës, me urdhër të Selisë së Shenjtë viziton dioqezën e Pultit dhe në letrën që i dërgon Kongregacionit të Shenjtë në vitin 1629 tregon se banorët e Pultit që nuk ranë nën zgjedhën e tiranisë turke nuk ia ndjenë zërin e as nuk ia panë fytyrën ndonjë peshkopi, prandaj ndoshta që nga shek. XV, kur Shqipëria ra nën zgjedhën turke, asnjë peshkop i pastajmë nuk ka mundur të shohë e të sundojë këtë dioqezë. Ai tregon se kjo dioqezë kishte shumë qytete e katunde dhe 23 famulli, se kishte vetëm dy meshtarë që u mësonin atyre popujve të vërtetat e fesë së krishterë e u bënë shërbimin fetar, se në ato vende bëheshin shumë mëkate nga padituria dhe zemrat e prishura, sidomos në bashkimin dhe në ndarjen e martesave, se ka krezmuar deri në 3300 vetë pasi nga mungesa e shërbimit dhe e administrimit peshkopal s'kishin mundësi e rast të merrnin atë sakrament. Kaq nga Benedikt Ursini.

Gati të gjitha këto i përforcojnë me letrat e veta dërguar Papës dhe Kongregacionit të Shenjtë Etërit Françeskanë, shërbyes të Ungjillit në atë krahinë. Dy prej tyre, Paulo Mantuan dhe Salvatori de Ofida, nga zelli i madh që kishin për mbrojtjen dhe përhapjen e fesë së Krishtit, pas shumë mudi e djerse që kishin derdhur në Epir, më 9 nëntor 1644 qenë vrarë mizorisht për fe të Krishtit në Kelmend, krahinë ngjitur me atë të Pultit. Ata etër kanë treguar se Pulti kishte 20.000 katolikë, shërbimi fetar i të cilëve peshonte krejt mbi shpatullat e dy meshtarëve dhe se nuk ka mbetur as kujtimi i ndonjë peshkopi që të ketë zhvilluar shërbim fetar atje.

Këtë dioqezë e përshkruan edhe Mark Krisius në letrën e vet të vitit 1653, atëherë kur vizitoi Shqipërinë si Legat Apostolik. Ai tregon se në ato vende ishin 25 katunde dhe se qyteti ishte krejt i rrënuar, sa nga vjetërsia, sa nga barbarizmat e turqve. Ai shkruan se në krahinën e Kelmendit, e cila është nën

peshkopatën e Pultit, janë më se 2500 të krishterë, të cilëve u bëjnë shërbim fetar françeskanët e rregullit të shtrënguar, të mjaftueshëm për gjithë atë popullsi. Është e pabesueshme të tregohet padija në punë të fesë e atyre popujve.

Nga këto e të tjera letra dhe njëkohësisht i shtyrë edhe prej ankimeve dhe lutjeve të popullit të Pultit, Papa Aleksandri VIII e pa të udhës të mendojë për atë dioqezë e për shërbimin e atyre popujve dhe të vendosë në vend dëshirën e tyre.

Vinçenci, peshkop i Pultit XVIII, viti 1656

Lindi në Kotorr, nga familja Joanela. Letërsinë dhe filozofinë i mësoi në Kolegjin Ilirik të Loretos. Si shkoi në Romë, me përkrahjen e Kardinalit Balneo dhe me ndihmën e Kongregacionit të Shenjtë, për ushqimin dhe shkollën, studioi teologjinë dhe juridikun deri në vitin 1644 dhe përparoi shumë. Kur e mbaroi shkollën, u caktua si bashkëpunëtor i Legatit të Selisë Apostolike pranë mbretit të Galëve me detyrën e teologut pranë tyre. Teksa gjendej në Francë, me vullnetin e atij kardinali frekuentoi shkollën e Parisit. Vetë legati, mbështetur në urdhrin e Kongregacionit të Shenjtë, e shuguroi meshtar me titull të misioneve, mbasi i pati dhënë të gjitha urdhrat e tjerë. Pasi u kthye në Romë, në vitin 1650, i pajisur me çdo gjë të nevojshme për udhëtim, qe dërguar në Dalmaci dhe vizitat apostolike i nisi në krahinën e Mainave, që i përkiste dioqezës së Budvës apo të Tivarit. I palodhur i shëtiti të gjitha katundet. Pastaj shkoi në Kotorr dhe ndihmoi peshkopin e Kotorrit, Vinçenc Bukia. Prej këtej u dërgua të vizitonte dioqezën e t'i mësonte popullit urdhëresat e Zotit dhe sakramentet. Ai e bëri edhe kanonik të Kotorrit. Vinçenci në vitin 1652 gjendej në Venedik dhe prej andej në tetor u dha një letër disa miqve pranë Kurjes Romane duke kërkuar t'i jepej dioqeza e Shkodrës dhe detyra e zëvendësit të Budvës.

Internunci Apostolik pranë venedikasve i dërgoi një letër më 8 shkurt 1653 Kongregacionit të Shenjtë dhe e mbuloi me lavde Vinçencin. Në vitin 1654 mbajti predikimet e kreshmëve në Katedralen e Farit tërë zell apostolik, duke luftuar veset e qytetarëve dhe duke i shtyrë me fjalë të fuqishme nga përshpirtëria e krishterë. Vinçenci peshkopi i Farit i lavdëroi ato predikime me një letër që i dërgoi Kongregacionit të Shenjtë.

Kishte kaluar shumë vite në udhëtime apostolike në ato vende të vështira malore me shumë mund, por edhe me shumë fryte. Papa Aleksandri VII pas dëshirës dhe lutjeve të pandërprera të popullit të Pultit ua caktoi për peshkop: "Më 10 janar 1656, Vinçenc Joanelin, sipas vendimit të Propagandës" nga Aktet Konçestoriale. Kjo ndodhi pasi Vinçenci nuk e pat pranuar selinë e Mitropolisë së Tivarit, siç shkruan vetë në një letër.

Por shpresa e madhe se ai, si peshkop, do të ripërtërinte gjendjen fetare të krishterë u zbeh dhe populli i Pultit u gënje.

Mbasi qe shuguruar peshkop shkoi në Venedik dhe ai që nuk pati asnjë frikë nga vuajtjet, mundi i madh e rreziqet për të zhvilluar veprimtarinë e vet apostolike në ato vise, u tremb tani nga vështirësia e udhëtimit detar në atë kohë plot rreziqe piratësh dhe nga turqit, që ishin në luftë me venedikasit. Qëndroi në Venedik një vit e disa muaj pa bërë asnjë punë. Nuk u tund nga asnjë letër ose urdhër i Kongregacionit të Shenjtë, që e urdhëronte të shkonte në selinë e caktuar. Sipas një letre që daton 30 dhjetor 1656, mendonte të jepte dorëheqje nga selia peshkopale e Pultit. Kur u thirr në Romë në vitin 1657, iu dha urdhri ta mbante atë detyrë dhe të rrinte në qytetin e Romës duke pritur rastin e përshtatshëm që të caktohej për ndonjë dioqezë tjetër apo si ndihmës i ndonjë peshkopi. I qenë caktuar 20 monedha argjendi në muaj për një jetesë të mjaftueshme e të përshtatshme për dinjitetin e tij. Por u mërzi edhe në atë qytet. Në vitin 1660 iku fshehurazi prej andej. Mendonte të shkonte në Venedik, që të mund të shtinte në dorë ndonjë detyrë fetare që t'i jepte të ardhura më të mira. Por kur mbërriti në Firence ndërroi mendim dhe u nis për në Spanjë e prej andej me qëllim që të shkonte në Portugali dhe Francë. Në Spanjë u kap nga ushtarët spanjollë dhe me urdhër të Mbretit u çua në Madrid. Me anë të peshkopit të Roderikut i tregoi Mbretit se kush ishte dhe se ishte peshkop. Nga Spanja shkoi në Janua. Në atë qytet qe pritur me nderim prej Kardinal Durracit. Ky tentoi t'ia mbushte mendjen që të mos shkonte në Kotorr, që thoshte se i përkiste, ku s'do të kishte qetësi dhe as do t'i kishte hije këmbës së tij prej peshkopi dhe i premtonte se do të bënte përpjekje ta vendoste në një detyrë të përshtatshme. Kaq jep letra e Durracit dërguar Kongregacionit të Shenjtë. Ndërsa peshkop Vinçenci po endej lart e poshtë, populli i Pultit nuk u ndal duke kërkuar që tek e fundit t'u dërgohej peshkop e kështu Papa Aleksandri VII emëroi peshkop të Pultit F. Hijacint de Secja, i Urdhrit Minor të Shën Françeskut. Por ky nga modestia ose për arsye se ishte e mundimshme nuk e pranoi atë nder e detyrë të rëndë. Vinçenci mbas shumë endjesh dhe pa shpresë, iku edhe nga Janua e vajti në Parmë në nëntor të vitit 1661 dhe duke mos gjetur strehë e duke mos pasur të holla të mjaftueshme për jetesë, më në fund u strehua në një bujtinë publike. Kur i qe njoftuar peshkopit të qytetit ardhja e tij dhe duke pasur dhimbsuri për të dhe respekt për titullin e tij, e largoi nga ajo bujtinë dhe e çoi në kuvendin françeskan. Mbasi ndenji disa ditë aty i nderuar dhe i ndihmuar më së miri, si e pajisi me të gjitha gjërat e nevojshme për udhëtim, e nisi për në Bolonjë dhe ia porosi Kardinalit Legat sundimtarit të atij qyteti. Kardinali Legat dha urdhër të përcillej në Romë me roje besnike. Papa e pa me vend ta mbyllte në kështjellën e Shën Engjëllit peshkopin endacak, që të mos mund të ikte për të kërkuar si lypës bukën e gojës duke turpëruar urdhrin dhe karakterin peshkopal.

Urban Cerrius, sekretar i Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës së Fesë, kur shkroi veprën e vet "Mbi gjendjen e tanishme të kishës romane" dhe ia paraqiti Papës Inoçenti XI, për peshkopin e Pultit, Vinçencin në fjalë tha:

“Peshkopata e Pultit ka më se 580 shtëpi katolike me 4500 banorë. Peshkopi i turbullt nga mendja dhe i dyshimtë nga feja mbahet me roje në Kështjellën e Shën Engjëllit dhe Kongregacioni i Shenjtë i jep për ushqim 10 monedha argjend në muaj. Ndërkaq dioqezën e Pultit e administron peshkopi i Sapës.”

Por karakterin e vet të turbullt e krenar që s’dinte ç’është pendimi e tregoi edhe më mirë kur në vitin 1664 nga burgu kërkoi Selinë Peshkopale të Arbrit, pas vdekjes së Pjetër Gaudencit. Se sa jetoi Vinçenci nuk kam dijeni, por nga burgu i Romës s’u lirua kurrë. F. Pjetër Antoni prej Venediku në “Viridardin Serafik” përmend dy peshkopë të Pultit pas Vinçencit, edhe ata nga Urdhri Françeskan: F. Hiacint de Secja, viti 1660, dhe F. Bernardin de Verona, i cili duke ndjekur shembullin e Hiacintit nuk e pranoi atë detyrë.

Ndër tabulat konçestoriale tregohet se pasi vdiq Vinçenci, qe emëruar:

Pjetri, peshkop i Pultit XIX, viti 1689

Mbiemri i tij ishte Karagjiç. Qe student në Kolegjin Ilirik të Loretos dhe Vikar Apostolik në Pult. Pasi i qenë rrëmbyer nga ushtria turke pasuritë e të atit dhe çdo e mirë tjetër, pas shumë vuajtjesh, shpëtoi vetëm jetën duke u struktur jo me qëllim të shpëtonte jetën e tij, por që t’u shërbente për të ardhmen shpirttrave. Prandaj Kongregacioni i Shenjtë i Propagandës së Fesë, pranë të cilit qe strehuar, si i dha Vikarjetin e Pultit në Epir, përsëri e ktheu në ato vende për të predikuar Ungjillin e pastaj u bë peshkop i Pultit. Prej andej më vonë qe ngritur në Selinë e Kryepshkopatës së Shkupit. Këto nga dokumentet e Kolegjit të Loretos. Kështu, si tregojnë Aktet Konçestoriale, “më 15 shtator 1689”, Papa Inoçenti XII emëroi për dioqezën e Pultit në Shqipëri, mbetur vakant me vdekjen e Vinçenc Joanelit, Pjetër Karagjiçin, meshtar i Shkupit, duke i dhënë në administrim edhe dioqezën e Shkupit, me lejen që të shugurohej peshkop nga një peshkop i vetëm duke qenë pranë dy dinjitarëve të tjerë. Pas katër vjetësh, me urdhër të Klementit, ai shkoi në vend të vet për të sunduar Mitropolinë e Shkupit: “Më 25 shtator 1701, papa e transferoi Pjetër Karagjiçin nga dioqeza e Pultit në atë të Shkupit, mbetur vakant nga dorëheqja e vullnetshme e Daniel Durancit”.

Marini, peshkop i Pultit XX, viti 1703

Ky qe nga Shkodra. Studioi në kolegjin e Fermos. Shërbeu si famullitar në Shas, në dioqezën e Shkodrës. Papa Klementi XI, siç tregojnë Aktet Konçestoriale, e ngriti në Selinë Peshkopale të Pultit. Më 29 nëntor 1703 emëroi Marin Gjinin, meshtar të dioqezës së Shkodrës, për dioqezën e Pultit mbetur vakant me transferimin e Pjetrit. Duhet të jetë zgjedhur dhe emëruar një vit më parë, ndërsa në këtë vit, 1703, në nëntor, qe emëruar botërisht në mbledhjen e kardinalëve. Në fillim të këtij viti mbante titullin “I Zgjedhur” dhe mori pjesë në Koncilin Kombëtar Shqiptar dhe nënshkroi Aktet Sinodale: “Unë Marin Gjini, i zgjedhur peshkop i Pultit, duke dhënë pranimin, po nënshkruaj.”

Në këtë koncil janë përshkruar dhe rreshtuar kufijtë e dioqezës së Pultit siç u tha në parathënie. E sundoi këtë dioqezë për gati 14 vjet, kur i qe dhënë urdhri të kalonte nga dioqeza e Pultit në atë të Sapës.

Pjetri II, peshkop i Pultit XXI, viti 1714

Mbiemri i tij qe Skura. Studioi në kolegjin e Fermos. Nga kleri i dioqezës së Durrësit qe ngritur në sundimin e dioqezës së Pultit. Qe zgjedhur peshkop i Pultit në vitin 1714. Një vit më parë, Kryepeshkopi i Durrësit në një letër që i dërgonte Papës e mbushi Pjetrin me lavde duke e paraqitur si njeri me mirësjellje të rrallë, me kulturë të spikatur të shpirtit dhe se meritat e tij e bënë të përmendur më fort se këdo tjetër në krahinën e Shqipërisë. Por për arsye të luftës turke të Korfuzit kundër venedikasve nuk mundën të bëheshin si zakonisht betimet e duhura mbi jetën e tij. Para se të përforcohej zgjedhja e tij me diplomën papnore, Kongregacioni i Shenjtë i Propagandës së Fesë e bëri Pjetrin vikar apostolik të dioqezës së Pultit derisa të merrte në dorëzim atë peshkopatë me fuqinë e letrës apostolike. Këtu lexojmë se kjo ndodhi në vitin 1719. Kështu thonë tabulat romane: Papa Klementi XI “më 10 maj 1719 emëroi për dioqezën e Pultit, mbetur vakant nga transferimi i Marin Gjinit në dioqezën e Sapës, Pjetër Skuran, meshtar i dioqezës së Durrësit.”

Marku peshkop i Pultit XXII, viti 1731

Mbiemri i tij qe De Lukis. Të gjitha mësimet i kreu në vitin 1712 në Kolegjin Ilirik të Loretos. Kur ishte vikar i Kryepeshkopit të Tivarit, Benedikti XIII e bëri peshkop të Pultit më 14 shtator 1731. Dy vjet më parë Vinçenc Smajeviçi, Kryepeshkop i Zarës, u pati dhënë për virtytet dhe meritat e Markut një dëshmi të shkëlqyer kardinalëve të Kongregacionit të Shenjtë. Për gati 14 vite e sundoi këtë dioqezë në dobi të grigjës që i ishte besuar. Në vitin 1745 nga dioqeza e Pultit ishte ngritur në atë të Tivarit. Mbi këtë shih te Kryepeshkopët e Tivarit.

Serafini, peshkop i Pultit XXIII, viti 1745

Lindi në vitin 1961 nga familja e ndershme Turriana në katundin Alcan të krahinës së Bergamos. Pati dy vëllezër, të cilët duke hequr dorë nga punët dhe kujdesi shtëpiak, njëri mori rrugën e meshtarit dhe tjetri hyri në Urdhrin e Shenjtë të Karmelitanëve, ku u dallua me kulturë, virtyt dhe me detyrën më të lartë të urdhrit. Serafini, duke marrë shembullin e vëllezërve, hyri në Urdhrin Françeskan të disiplinës së shtrënguar. Në moshën 26-vjeçare, si kreu kohën e provës dhe u gjykua i rregullt nga e gjithë jeta e tij, qe urdhëruar të shkonte në Romë, ku në kolegjin e urdhrit të vet filloi teologjinë në vitin 1716. I zjarrtë për të përhapur fenë, pak më vonë, më 1717, ia kushtoi veten misioneve apostolike në Shqipëri. Në ato 12 vjet që kaloi në misione ushtroi edhe detyrën e Prefektit në dobi të shpirtit. Kur në atë kolegji po mësonte gjuhën shqipe duke u

kujdesur për çdo që u nevojitej etërve të urdhrit të vet, u zgjodh që nga viti 1745 nga Kongregacioni Shenjtë i Propagandës së Fesë. Po atë vit mori në sundim dioqezën e Pultit dhënë nga papa, ndërsa Kongregacioni i Shenjtë kishte menduar ta çonte diku tjetër me detyrën e peshkopit. Për gati katër vjet e sundoi në vend dioqezën e Pultit, por nga shëndeti i dobësuar që detyruar të kthehej përsëri në Romë e pastaj shkoi në Bergamo. Në këtë ajër të shëndetshtëm mund të përmirësohej nga shëndeti. Nga frika se populli i Pultit do të pësonte dëme nga mungesa e gjatë e bariut dhe duke parë edhe kujdesin që tregonte Papa për atë dioqezë, ai dha dorëheqje nga ajo detyrë peshkopale në vitin 1756. Por as në Bergamo nuk ndenji gjatë pa punë. Duke qenë se peshkopi i Bergamos ishte i vjetër dhe i pafuqishëm, ushtroi detyrën e peshkopit në atë dioqezë deri në fund të jetës së vet aq me lavdi e nder për nga pikëpamja fetare dhe urtësia, sa që çmuar shumë nga i gjithë kleri dhe shtresat e qytetarëve. Mënyra e jetesës së tij ishte kjo: në të dielat e shenjta shkonte në kuvend të qytetit, i quajtur i Hireve, në kreshme shkonte në atë të Alcanit, ku studionte dhe kryente detyrat e veta. Në kohë të tjera të vitit banonte pranë peshkopit në banesë të tij. Ai e shpërblente me një pension të hijshëm për jetesën e tij sa që gjallë. Vdiq në Bergamo në moshën 71-vjeçare në kuvendin e vet më 24 dhjetor 1762, me pikëllimin e madh të të gjithëve. Në funeralin e tij morën pjesë peshkopi dhe mbarë kolegji i kanonikëve. Trupi i tij u varros në kishën e urdhrit të tij. Në nekrologun e atij kuvendi është shkruar ky lavd për të: "Më 28 dhjetor, i Përndritshmi dhe i Përndershmi At Serafin Turriani nga Alcani, Prefekt e pastaj Prokurator i Përgjithshëm i Misioneve e më vonë peshkop i Pultit, e më në fund pas 17 vitesh peshkop, i shkëlqyer për nga urtësia, përkushtimi dhe sjellja e mirë, vdiq përshpirtërisht në kuvendin e Shën Mërisë së Hireve në Bergamo. Aty u varros me nderime në vitin 1762, në moshën 71-vjeçare."

Gjergji, peshkop i Pultit XXIV, viti 1756

Mbi këtë shih te peshkopët e Tivarit. Në vitin 1756 që shpallur peshkop i Pultit, nga letra e Papës dërguar më 3 janar, megjithëse pa i mbushur ende tridhjetë vjet. Mbasi e sundoi me lavd dhe nder këtë dioqezë për gati dhjetë vjet, që urdhëruar prej papës më 10 dhjetor 1765 të shkonte në dioqezën e Lezhës. Këtë dioqezë e sundoi për 6 vjet i dalluar për modesti, kulturë dhe për nga e mira për njerëzit. Në vitin 1771 që Vikar Apostolik në dioqezën e Sofjes, kur peshkopi i atij vendi e la atë seli i zgjedhur për dioqezën e Shkodrës. Pastaj u ngrit në Selinë e Mitropolisë së Tivarit më 23 korrik 1786, si shihet nga letra e Papës.

Aleksandri, peshkop i Pultit XXV, viti 1766

Ky u lind në dioqezë të Lezhës nga familja Bardhi rreth vitit 1732. Si i kreu në Romë studimet në Kolegjin Urban, me shumë lavd për nga mendjehollësia e

modestia, kthehet në atdhe. Këtu iu përvesh punës sa duke u dhënë fëmijëve mësimet fetare e shkollore, sa duke shpjeguar katekizmin e krishterë dhe duke kryer punët e tjera të një meshtari të zellshëm e të përsëritshëm si në shumë famulli të ndryshme ashtu edhe në qytetin e Velës, me urdhër të peshkopit të Lezhës. Ky para se të vdiste i lëshoi në dorë kolegjin e klerit të Lezhës dhe titullin e detyrës së Vikarit Apostolik të asaj dioqeze. Për më tepër, me një letër që ky peshkop i dërgoi Kongregacionit të Shenjtë të Propagandës së Fesë i lëvdoi lart virtytet dhe meritat e tij në çështje të fesë dhe kërkoi të bëhej peshkop pasardhës i veti. Të këtij mendimi qenë edhe peshkopi i Tivarit, i Durrësit dhe i Shkodrës. Gjithë këta njëzëri tregojnë jetën e përpiktë të Aleksandrit, karakterin e butë të tij dhe kulturën e gjerë, siç tregojnë në letrat që i dërgojnë Kongregacionit të Shenjtë. Peshkop i Pultit u bë në vitin 1766. Këtë dioqezë e sundoi për gati 14 vjet me shenjtëri deri në vitin 1780, kur edhe vdiq.

Gjoni III, peshkop i Pultit XXVI, viti 1781

Mbiemri i tij qe Logoreci. Qe prej Brijës, së dioqezës së Shkodrës. Studioi në kolegjin urban. Në moshë 53-vjeçare, kur ishte vikar i përgjithshëm i Kryepeshkopit të Tivarit, u ngrit në detyrë në Selinë Peshkopale të Pultit, më 2 prill të vitit 1781. Me urdhër të Papës Piu VI, shkoi në Selinë Peshkopale të dioqezës së Sapës.

Marku, peshkop i Pultit XXVII, viti 1791

Papa Piu VI, në 26 shtator 1791, e bëri peshkop të Pultit ndërsa po kryente detyrat e meshtarit në dioqezë të Sapës, ku kishte lindur nga familja Zezaj (Nigra). Edhe ky e nderoi kolegjin urban me virtyte të veta. Pas disa vitesh që si bari i mirë po kujdesej për të mirën e popullit të Pultit, me urdhër të Papa Piu VII kaloi në sundimin e dioqezës së Sapës.

Engjëlli, peshkop i Pultit XXVIII, viti 1816

Mbi zgjedhjen e këtij peshkopi nuk kam asnjë të dhënë. Mbiemri i tij qe Kallmeti. Me urdhër të Papa Piu VII, qe transferuar në sundimin e dioqezës së Cuprae Montanae më 17 prill 1816.

PESHKOPËT E PULTIT TË VOGËL

Para shek. XIV nuk shihet asnjë dallim mes dioqezës së Pultit të Madh e asaj të Pultit të vogël. Një peshkop i vetëm i shërbente mbarë krahinës së Pultit. Në vitin 1331 filluan të shihen dy peshkopë, një për Pultin e madh e një tjetër për Pultin e Vogël. Të dy në të njëjtin vit i paguajnë "Tagrambledhësit Apostolik të dhjetën trevjeçare", që i detyroheshin. Peshkopi i Pultit të Madh

pagoi "40 solda të trasha". Gregori, peshkopi i Pultit të Vogël apo i Skordit pagoi 10 solda të trasha. Nga Kodi i Pagesave të bëra Dhomës Apostolike 192, fq. 188. Në vitin 1372, për arsye skamjeje qenë liruar nga detyra e atyre të dhjetave, bashkë me të tjerë peshkopi të krahinës së Tivarit, "ai i Skordit d.m.th. i Pultit të Vogël dhe ai i Pultit të Madh", siç shihet nga Kodi i Pagesave të bëra Dhomës Apostolike bl. 240, fq. 269. Vërtetohet, siç thamë, se Pulti i Vogël quhej edhe Skord (Scordiensis dhe Scordinensis). Që atëherë e mbrapa për t'u dalluar, nga peshkopët e Shkodrës kjo dioqezë qe quajtur me fjalën e re Scutarensis. Qyteti i Shkodrës në kohë të vjetra quhej Scodra e më vonë quhet Scutari.

Kur përmendet peshkopi i Pultit thjesht pa ndonjë fjalë tjetër duhet kuptuar i Pultit të Madh. Pulti i Madh nga Pulti i Vogël ndahet nga mali i quajtur Ndërmaje. Krahina këndeje malit quhet Pult i Vogël, kurse ajo përtej malit quhet Pulti i Madh. Për peshkopët e Pultit të Vogël s'kam njoftime të tjera përveç emrave të tyre.

1. N N	viti nuk dihet
2. Gjoni	viti 1345
3. Gregori	viti 1351
4. N. N.	viti 1364
5. N. N.	viti 1372
6. Dusi	viti 1427
7. Gjergji	viti 1446
8. Damjani	viti 1450
9. Margarini	viti 1467
10. Pjetri	viti 1508
11. Didaku	viti 1508
12. Deda	viti 1513
13. Majoriu	viti 1518
14. Vinçenci	viti 1520

N. N. peshkop i Pultit të Vogël I, viti nuk dihet

Ky njihet nga regjistrat e Papës Klement VI, si do të konstatohet më poshtë. Thuhet se qe para Gjonit, që e pason në sundimin e kësaj dioqeze të Pultit të Vogël. Prandaj ky peshkop anonim duhet të vihet si peshkop i Pultit para vitit 1340.

Gjoni, peshkop i Pultit të Vogël II, viti 1345

Ky qe domenikan. Papa Klementi VI e zgjodhi peshkop të Scordit, domethënë të Pultit të Vogël, më 4 korrik 1345, pasi vdiq peshkopi i mëparshëm (i dioqezës së Pultit të Vogël) në krahinën e Tivarit. Kaq jepet në

Regjistrin viti. IV, lib. 6, fq. 41. Për këtë Gjon nuk thonë asnjë fjalë shkrintarët e urdhrit të tij domenikan.

Gregori, peshkop i Pultit të Vogël III, viti 1351

Ky quhet edhe i Skordit. Në vitin 1351 pagoi, si kemi thënë, të dhjetat e trevjeçarit të kaluar. Në kodin e Pagesave të Dhomës Apostolike thuhet: "Tagrambledhësi Apostolik i të dhjetës trevjeçare mori nga Gregori peshkopi i Pultit ase ndryshe Skordit 10 solda të trasha".

N.N. peshkop i Pultit të Vogël IV, viti 1364

Në vitin 1364, ky kishte në dorë sundimin e kësaj dioqeze. Në Kodin 453, të të hyrave e të dalave të Dhomës Apostolike fq. 200, ka këtë titull "Taksa e prokurave të detyrueshme e të paguara Egjdit, peshkopit të Sabinit për 2, 3, 4, 5 vjet të dërgimit të parë të tij deri më 1 tetor 1364" nga të gjithë peshkopët e krahinës së Tivarit, pa i përmendur emrat e tyre, por duke shënuar "Peshkopi i Pultit, peshkopi i Skodonit, peshkopi i Shkodrës". Peshkopi i Skodonit tjetër nga ai i Pultit dhe nga ai i Shkodrës, s'mund të jetë tjetër veçse peshkopi i Pultit të Vogël, që duket se thirret herë i Skodonit e herë i Skordit.

N. N. peshkop i Pultit të Vogël V, viti 1372

Ky quhet edhe Scordinensis. Ky me atë të Pultit, të Shkodrës e të tjerë peshkopë të krahinës së Tivarit tregohet se kanë qenë përjashtuar nga detyra e të dhjetave për arsye skamjeje. Kaq nga Pagesa e Dhomës Apostolike bl. 240, fq. 269.

Dusi, peshkop i Pultit të Vogël VI, viti 1427

Të tjerë këtë e quajnë Dushman. Ishte meshtar i dioqezës së Pultit, si shihet nga tabulat romane të Papa Martinit V. Në vitin 1427 kishte në dorë sundimin e kësaj dioqeze dhe e mbajti deri në vitin 1446, kur edhe vdiq.

Gregori, peshkop i Pultit të Vogël VII, viti 1446

Qe meshtar shqiptar. Erdhi në selinë Peshkopale të Pultit të Vogël në vitin 1446. Pas tij u vu në këtë seli

Damjani, peshkop i Pultit të Vogël VIII, viti 1450

Përveç emrit nuk dimë gjë tjetër për të. Qe bërë peshkop në vitin 1450. Duket se vdiq më 1467, pasi në atë vit qe emëruar.

Margarini, peshkop i Pultit të Vogël IX, viti 1467

Ishte kanonik i kishës së Shën Pjetrit në Tivar. Zgjedhja e tij peshkopale bëhet më 7 janar 1467.

Pjetri peshkop i Pultit të Vogël X, viti 1508

Në tabulat e Vatikanit tregohet se më 10 janar 1508 u emërua peshkop i kësaj dioqeze Pjetër Xanji. Por e la shpejt atë seli sepse u largua vullnetarisht ose vdiq.

Didaku, peshkop i Pultit të Vogël XI, viti 1508

Vadingu tregon se nga familja françeskane qe ngritur në Selinë Peshkopale të Shkodrit më 10 dhjetor të vitit 1508. "Më 10 dhjetor, F. Didak N. u bë peshkop i Skodrit (Scodrinensis) nën të njëjtin Kryepeshkop të Tivarit".

Dominiku, peshkop i Pultit të Vogël XII, viti 1513

Aktet peshkopale të dioqezës së Kotorrit nuk lejojnë të hiqet ky nga katalogu i peshkopëve të Pultit . Në ato akte lexojmë në vitin 1513 këto fjalë: "Më 29 janar 1513 i Nderuari në Krishtin Atë, Z. Dominik Krutbi, peshkop i Pultit të Vogël, në pallatin peshkopal me leje të të Nderuarit Vikar, që qe pranë, vlashi i Gjergjit de Kastro Novo, në moshë të ligjshme, dëshiron të hyjë në ushtrinë e klerit dhe me kërkesën e tij, duke i prerë flokët me duart e veta, bëri shenjën klerikale duke i dhënë tonsurën klerikale sipas rritit të Kishës së Shenjtë Romane, duke pasur pranë Mateo Somçiqin, nëndhjak i Kotorrit.

Majoriu, peshkop i Pultit të Vogël XIII, viti 1518


Mbiemri i tij ishte Somo. Tabulat Konçisterjale tregojnë se Leoni X "më 12 prill 1815 e emëroi për dioqezën e Pultit të Vogël në Epir", domethënë në Shqipëri. "Zotëri Majoriun Somo, komendatar i Shën Sofisë në dioqezë të Sardës. Të ardhurat 50 fiorinë. Taksa 33."

Vinçenci, peshkop i Pultit të Vogël XIV, viti 1520

Ky qe nga Skalona, i Urdhrit të Predikatarëve. Duke qenë shumë i zellshëm për të mirën e shpirttrave, predikues i madh dhe mik i përzemërt i kardinal Tomas nga Vio Kajetano, qe bërë peshkop i Pultit të Vogël më 13 qershor 1520, siç shihet nga Aktet Konçistoriale. Fontana në Theatrium Domenicanum pjesë 1, fq. 267, dioqezën e Pultit të Vogël e ngatërron me atë të Pultit të Madh. Vinçencin dhe Martinin prej Polonie, peshkop të Pultit të Madh, pa dallim i quan peshkopë të Pultit. Për Vinçencin shkruan kështu: "Atë F. Vinçenc Skalona nga krahina e Dalmacisë qe bërë peshkop i dioqezës së Pultit, nën Mitropolitin e Tivarit në Sklavoni, prej Papës Leonit X, ditën e premte më 1 korrik 1520. Këta nga Aktet Konçistoriale të të njëjtit papë Leon." Por ose në kopjen tonë të Fontanës, të nxjerra nga Aktet Konçistoriale, muaji e dita janë gabim.

Pas këtij peshkopi nuk gjej tjetër peshkop të Pultit të Vogël. Ndoshta në këtë kohë dy dioqezat e Pultit janë bashkuar në një dioqezë të vetme kur Laurent Santareli administronte dioqezën e Pultit të Madh.

Që atëherë një peshkop i vetëm i sundonte të dyja dioqezat, ashtu si edhe sot, në qoftë se ndonjë pjesë e dioqezës së Pultit të Vogël nuk i është dhënë ndonjë peshkopi tjetër kufitar.



EPISCOPI CROJENSES.

Croja no-
men, situs,

Croja, ignota urbs antiquis, in Epiro est, a fontibus, qui pereanes per montis juga, in quo eminet, scaturiunt, effluuntque in subjectam planitiem, nomen sortita, fons enim *Croja* dicitur Epirotica lingua. Sunt, qui autumant, Crojam e ruderibus Antigoniam eversae urbis esse exortam; quae opinio est Ortelii, Ferrarii, Baudrandi, a Sophiano, & a Lazio accepta; sed falluntur; longe enim diversa utriusque fertur positio, & unius ab altera remotissima. Antigoniam propter Acroceraunios meridiem respicit, ac prope Canovia adest, interjecto Cœlidno flumine, nunc *Scumino*; Croja vero in septentrionem insidet monti, quem Issimus præterfluit, ejusque ager cum Alexiensis, & Dyrrhachiensi conjungitur. A se ipso certe dissidet Baudrandus, qui, *Antigoniam*, inquit in sua Geograph., *urbs Epiri mediterranea in Chaonia tractu, teste Ptolemaeo, nunc Niger interpretatur Argirocastro, oppidulum ejusdem regionis versus Macedonia finis, & 25. mill. pass. distans a Chimora urbe in montibus Acrocerauniis*; deinde ad litteram *C. Croja*, subdit, *urbs Albanie caput juxta Litanam fluvium, olim Antigoniam dicta sive Eribea, ut alii malunt, vix 25. milliaribus distat ab ora maris Adriatici in ortum & 35. a Dyrrhachina*. Nam Chaonia

pars erat veteris Epiri, nunc *la Cavina* appellatur, in qua si Antigoniam colles, quid huic urbi cum Croja, quæ ad Albaniam, nempe ad Epirum novam pertinet, ejusque caput dicitur a Baudrandis? Minus distat a vero, Eribeam existisse ante in ipso, vel priori Croja loco, quæ est Moletii opinio apud eundem Baudrandum; *Eribea urbs Macedonia in Parthis Ptolemaeo, cum monte cognomine, nunc sive Moletio Croja urbs Albanie regionis primaria*. Etenim Parthizii, seu Parthini hanc incolere olim regionem, de quibus in tomo 1. pag. 90., & *Parthiarum Eribea*, scribit Ptolemaeus lib. 3. cap. 13., cui montem cognominem adjicit Polyæus lib. 4. Stratag. in cujus vertice urbs forte erat exstructa, unde mulieres Taulantios, qui in montis juga conscensionem parabant, felici stratagemate abigerunt in fugam. Verum hæc conjecturæ sunt, quibus non est innitendum; addo tamen, pagum *Præpa*, a Moletio prope Eribeam reliquias positum longissime abesse inde ultra Ducaginos ad lacum ejusdem nominis; illos autem falli, qui Crojam cum Albanopoli confundunt, uti in Episcopis Albanensibus dictum.

Masinius Barletius & Maurus Orbinus & coaditor
sec. XIII.
Crojam conditorem perhibeat Carolum Topiam, seu, ut alii eum appellant, *Tabiam*,

Ccc a Tφ